


Deloitte.



Raporti i Transparencës 2023

Deloitte Audit Shqipëri Shpk

31 mars 2024



Përmbajtja

Mesazhi i Drejtimit të Deloitte Audit Shqipëri Shpk	2
Rrjeti Deloitte	3
Angazhimi ynë për t'i shërbyer interesit publik	6
Monitorimi i cilësisë së Auditimit të jashtëm dhe të brendshëm	20
Pavarësia, etika dhe shënimet shtesë	21
Shtojcat	26
Shtojca A Informacioni financiar	28
Shtojca B Njësi me Interes Publik	29

Mesazhi i Drejtimit të Deloitte Audit Shqipëri Shpk

Ky raport paraqet praktikat dhe proceset, të cilat aplikohen aktualisht nga Deloitte Audit Shqipëri Shpk, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.



I gjithë informacioni i dhënë në këtë raport lidhet me situatën e Deloitte Audit Shqipëri më 31 dhjetor 2023, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe.

Cilësia është në qendër të profesionit tonë dhe shërben si themeli i biznesit tonë të Auditimit dhe Dhënies së Sigurisë. Cilësia përcakton brand-in tonë dhe ne përpiqemi të vendosim standardin e përsosmërisë për profesionin tonë. Fokusi ynë në përsosmërinë profesionale dhe përmirësimin e vazhdueshëm na lejon të përmbushim rolin kritik që luajmë në forcimin e integritetit të tregjeve të kapitalit. Angazhimi ynë për sjelljen etike dhe për të përqaftuar standardet sipas të cilave mbahet profesioni ynë – bazuar në objektivitet, gjykim profesional dhe skepticizëm – është thelbi i gjithçkaje që bëjmë.

Ne i rrënjosim këto vlera te njerëzit tanë, të cilët janë pasuria jonë më e madhe. Me ritmin e përshpejtuar të ndryshimeve në treg, ne po punojmë për të transformuar modelin tonë të talenteve duke ndërtuar një organizatë të bazuar në aftësitë dhe të ushqyer nga mundësitë kuptimplota të zhvillimit të karrierës dhe rrugët për të mësuar, rritur dhe zhvilluar. Ne mbetemi të përkushtuar për nxitjen e cilësisë së lartë, duke ofruar një përvojë talenti të klasit botëror të fokusuar në zhvillimin profesional dhe avancimin e diversitetit, barazisë, dhe përfshirjes në biznesin tonë dhe profesionin tonë.

Njerëzit tanë ndihmohen nga investimet e domethënëse që kemi bërë për të rinovuar modelin tonë të zbatimit, për të përmirësuar cilësinë e Auditimit dhe për të përmbushur nevojat në zhvillim të publikut investues dhe tregjeve të kapitalit. Teknologjia po ndryshon me një ritëm të shpejtë dhe ne vazhdojmë të vlerësojmë, kuptojmë dhe inkorporojmë përparimet teknologjike në biznesin tonë të Auditimit dhe Dhënies së Sigurisë. Për shembull, ne jemi të fokusuar në përfshirjen e kapaciteteve teknologjike të avancuara, të tilla si inteligjenca artificiale në proceset dhe metodologjitë tona të biznesit. Ne jemi entuziastë nga mundësitë që shtrihen para profesionit tonë dhe jemi të përkushtuar për të shfrytëzuar fuqinë e transformimit për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve tona të Auditimit dhe dhënies së sigurisë.

Raport i Transparencës 2023 ofron një vështrim të thellë të strukturës, qeverisjes dhe qasjes sonë për ofrimin e shërbimeve të Auditimit dhe dhënies së sigurisë me cilësi të lartë—të gjitha këto mbështeten nga sistemi ynë i fuqishëm i kontrollit të cilësisë. Ne e publikojmë këtë raport çdo vit për të ofruar informacione shpjeguese për kategori të caktuara informacioni që lidhen me qeverisjen e korporatave dhe transparencën. Ne mirëpresim mundësinë për të ofruar këtë informacion në lidhje me biznesin tonë dhe angazhimin tonë ndaj interesit publik me një grup më të gjerë palësh të interesuara.

Faleminderit për interesimin tuaj për të mësuar më shumë rreth angazhimit tonë të palëkundur ndaj cilësisë së Auditimit.

Sinqerisht,

Enida Cara FCCA, AL
Administratore
Deloitte Audit Shqipëri Shpk

Rrjeti Deloitte

Deloitte Audit Shqipëri: struktura ligjore dhe pronësia

Deloitte Audit Shqipëri Shpk është e lidhur me rrjetin Deloitte nëpërmjet Deloitte Central Europe Holdings Limited, një firmë anëtare e Deloitte Touch Tohmatsu Limited. Deloitte Central Europe Holdings Limited, së bashku me Deloitte France, Deloitte Germany, Deloitte Luxembourg, Deloitte Austria, Deloitte Portugal dhe Deloitte Turkey është një aksioner në Deloitte DCE GmbH ("DCE"), e cila është gjithashtu një firmë anëtare e Deloitte Touche Tohmatsu Limited. Objekti i DCE është nxitja e bashkëpunimit midis aksionerëve të saj si anëtarë të rrjetit global Deloitte. DCE as nuk ofron shërbime profesionale dhe as nuk angazhohet në aktivitete tregtare.

Deloitte Audit Shqipëri Shpk në të gjithë këtë raport quhet "Deloitte Audit Shqipëri". Deloitte Central Europe, si një organizatë entitetesh të organizuara nën ombrellën e Deloitte Central Europe Holdings Limited, në të gjithë këtë raport përmendet si "Deloitte Central Europe". Deloitte Central Europe Holdings Limited ka të drejta praktike për të ofruar shërbime profesionale duke përdorur emrin "Deloitte" të cilin e shtrin për entitetet Deloitte brenda territorit të saj (Deloitte Central Europe, duke përfshirë Deloitte Audit Shqipëri. Deloitte Audit Shqipëri është i autorizuar të shërbejë si Auditues për klientët në Shqipëri

Mbajtësit e kuotave janë si më poshtë:

- Olindo Shehu – 51%
- Deloitte Central Europe Holdings Limited - 49 %

Deloitte Audit Shqipëri operon si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar sipas ligjit shqiptar, me seli në rr. "Kavajë", Rezenca Delijorgji, Pallati H, Kati 2, Tiranë, Shqipëri dhe numër regjistrimi L41709002H


Kërkesa për licencim për pajtueshmërinë statutores

Deloitte Audit Shqipëri sh.p.k. është regjistruar në regjistrin publik të Audituesve Ligjor pranë Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) më 31 korrik 2014 me numër license 423.

Përshkrimi i rrjetit

Rrjeti Deloitte

Rrjeti Deloitte (i njohur gjithashtu si organizata Deloitte) është një rrjet i lidhur globalisht i firmave anëtare dhe entiteteve të tyre përkatëse të lidhura që operojnë në më shumë se 150 vende dhe territore në të gjithë botën. Këto firma anëtare të veçuara dhe të pavarura operojnë nën një brand të përbashkët.



Deloitte Touche Tohmatsu Limited (DTTL ose Deloitte Global)

Deloitte Touche Tohmatsu Limited është një kompani private në Mbretërinë e Bashkuar e kufizuar me garanci e inkuorporuar në Angli dhe Uells. DTTL shërben një rol koordinues për firmat e saj anëtare dhe entitetet e tyre të lidhura duke kërkuar respektimin e politikave dhe protokolleve me objektivin e promovimit të një niveli të vazhdueshëm cilësie, sjelljeje profesionale dhe shërbimi në të gjithë rrjetin Deloitte. DTTL nuk ofron shërbime profesionale për klientët, ose nuk drejton, menaxhon, kontrollon ose zotëron ndonjë interes në ndonjë firmë anëtare ose entitete të lidhura me ndonjë firmë anëtare.

"Deloitte" është brandi nën të cilën rreth 457,000 profesionistë dhe praktikues të përkushtuar në firma të pavarura në të gjithë botën bashkëpunojnë për të ofruar auditim dhe dhënie sigurie, konsulencë, këshillim financiar, këshillim për rrezikun, taksa dhe shërbime të ngjashme për klientët e përzgjedhur. Këto firma janë anëtarë të DTTL. DTTL, këto firma anëtare dhe secili prej entiteteve të tyre përkatëse të lidhura formojnë organizatën Deloitte. Çdo firmë anëtare e DTTL dhe/ose subjektet e lidhura me të ofron shërbime në zona të veçanta gjeografike dhe i nënshtrohet ligjeve dhe rregulloreve profesionale të vendit ose vendeve të veçanta në të cilat ato operojnë. Çdo firmë anëtare e DTTL është e strukturuar në përputhje me ligjet kombëtare, rregulloret, praktikën zakonore dhe faktorë të tjerë dhe mund të sigurojë ofrimin e shërbimeve profesionale në territoret e saj përkatëse nëpërmjet subjekteve të lidhura. Jo çdo firmë anëtare e DTTL ose subjektet e lidhura me të ofron të gjitha shërbimet dhe disa shërbime mund të mos jenë të disponueshme për të vërtetuar klientët sipas rregullave dhe rregulloreve të kontabilitetit publik. DTTL, dhe çdo firmë anëtare e DTTL dhe secili prej entiteteve të lidhura me të, janë entitete ligjrisht të ndara dhe të pavarura, të cilat nuk mund të detyrojnë njëra-tjetrën në lidhje me palët e treta. DTTL dhe çdo firmë anëtare e DTTL, dhe entitetet e tyre përkatëse të lidhura, janë përgjegjës vetëm për veprimet dhe mosveprimet e tyre, dhe jo ato të njëra-tjetrës. Organizata Deloitte është një rrjet global firmash të pavarura dhe jo një partneritet apo një firmë e vetme. DTTL nuk ofron shërbime për klientët.

Deloitte Audit Shqipëri: qeverisja – lidërimi në veprim

Bordi i Drejtuesve të Deloitte Audit Shqipëri është përgjegjës për qeverisjen dhe mbikëqyrjen e praktikës së Auditimit dhe Dhënies së Sigurisë. Përgjegjësitë specifike përfshijnë miratimin e strategjisë së biznesit të Auditimit dhe Dhënies së Sigurisë vendor dhe miratimin e aspekteve financiare të planeve të biznesit lokal në Shqipëri.

Më poshtë janë anëtarët e Bordit të Drejtuesve të Deloitte Audit Shqipëri, të cilët janë emëruar nga mbledhja e aksionerëve për një periudhë 4-vjeçare nga data e emërimit dhe të përbërë nga Auditues të Autorizuar Ligjorë :

Deloitte Audit Shqipëri – Bordi i Drejtuesve

Olindo Shehu – Administrator

Enida Cara - Administratore

Gregory Paul Rossouw - Administrator

Ortakët dhe drejtuesit e mësipërm veprojnë si administratorë të Deloitte Audit Shqipëri, në përputhje me Statutin e Shoqërisë në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për sipërmarrësit dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Deloitte Audit Shqipëri ka 59 punonjës profesionale më 31 dhjetor 2023.

Në të gjitha aktivitetet e tyre, drejtuesit e lartë të Deloitte Audit Shqipëri janë përgjegjës për objektivin kryesor të cilësisë së Auditimit, duke përfshirë përputhjen me standardet profesionale dhe kërkesat rregullore në fuqi. Strategjia e Deloitte Audit Shqipëri është zhvilluar në përputhje me drejtimin e përgjithshëm strategjik të vendosur për rrjetin Deloitte.

Drejtesit e Deloitte Audit Shqipëri marrin pjesë në grupet e rrjetit Deloitte që vendosin dhe monitorojnë standardet e cilësisë dhe nga të cilët burojnë një sërë iniciativash për cilësinë e Auditimit.

Qëllimi dhe angazhimi ynë: të nxitim besim dhe konfidencë

Në Deloitte Audit Shqipëri, qëllimi ynë është të krijojmë një ndikim që tejkalon pritshmëritë. Për Auditimin dhe Dhënien e Sigurisë, kjo do të thotë zhvillim i vazhdueshëm i proceseve të Auditimit dhe dhënies së sigurisë, shfrytëzimi i teknologjisë më të avancuar, aplikimi i një shumëllojshmërie aftësish, njohurish dhe përvojash për të ofruar shërbime me cilësi të lartë. Ne jemi shumë krenarë për rrënjosjen e besimit dhe konfidencës në tregjet e kapitalit dhe jemi të përkushtuar për të lartësuar pa pushim standardet e cilësisë dhe duke vepruar gjithmonë me integritet, pavarësi dhe transparencë. Ne po ndërtojmë vazhdimisht aftësitë tona për të mbështetur ofrimin e auditimeve cilësore dhe angazhimeve të tjera të dhënies së sigurisë dhe për kontribute parimore në formimin e së ardhmes së profesionit të auditimit.



Angazhimi ynë për t'i shërbyer interesit publik

Një fokus në cilësinë e Auditimit

Angazhimi i Deloitte për cilësinë e Auditimit përshkon gjithçka që bëjmë. Auditimi i pavarur është një element qendror i ekosistemit të raportimit të korporatave, i vendosur për të rritur besimin dhe konfidencën e investitorëve dhe palëve të tjera të interesuara, si dhe për të promovuar funksionimin efektiv të tregjeve të kapitalit. Deloitte është shumë i vetëdijshëm për detyrimin tonë për të ofruar shërbime auditimi që plotësojnë sfidat dhe kompleksitetet e mjedisit aktual, duke qenë në përputhje me standardet profesionale dhe rregullatore. Që ekosistemi i raportimit të korporatës të funksionojë siç synohet, është jetike që roli i Audituesit të ekzekutohet në mënyrë efektive.

Deloitte është e përkushtuar të bëjë më shumë sesa thjesht përmbushjen e kërkesave rregullatore dhe konform pritshmërive. Deloitte po shkon përtej pritshmërive për të vendosur standardin e përsosmërisë për profesionin. Në përputhje me këtë objektiv, angazhimi ynë për cilësinë e Auditimit është i padiskutueshëm.

Shoqëritë e audituara prej Deloitte Audit Shqipëri

Si pjesë e angazhimit të Deloitte Audit Shqipëri për të mbështetur tregjet e kapitalit, ne foksohemi në auditimin e subjekteve të cilat i shërbejnë interesit publik dhe ku ne kemi aftësitë për të kryer një auditim cilësor me objektivitet dhe në përputhje me standardet profesionale dhe ligjeve dhe rregullacioneve ne fuqi, përfshirë ato që lidhen me etikën dhe pavarësinë.

Shoqëria që mbajmë është një aspekt i rëndësishëm i strategjisë sonë të Auditimit dhe Dhënies së Sigurisë dhe vlerave të përbashkëta që drejtojnë sjelljen tonë për të udhëhequr rrugën, për të shërbyer me integritet, për t'u kujdesur për njëri-tjetrin, për të nxitur përfshirjen dhe për të bashkëpunuar për një ndikim të matshëm. Pyetja që i bëjmë vetes është: me çfarë lloj shoqërisht duam të lidhemi? Për t'u përgjigjur kësaj pyetjeje, është zhvilluar një deklaratë e tolerancës për rrezikun e auditimit dhe dhënies së sigurisë për të shërbyer si bazë për shoqërinë që duam të mbajmë. Deklarata e tolerancës së rrezikut mund të përdoret si një mjet për të promovuar një diskutim të fortë të rrezikut si dhe një bazë mbi të cilën vendimet e pranimi dhe të vazhdimësisë mund të debatohen dhe sfidohen në mënyrë efektive dhe të

besueshme. Deklarata, siç tregohet më poshtë, përcakton tonin për tolerancën e rrezikut dhe synon të nxisë konsistencën në procesin vendimmarrjes së pranimi të angazhimit dhe vazhdimësisë:

“Toleranca e rrezikut së portofolit të Auditimit dhe Dhënies së Sigurisë (A&A) të Deloitte mbështet axhendën tonë të udhëhequr nga qëllimi dhe përforcon Parimet tona të Sjelljes së Biznesit, të cilat artikulojnë standardet që ne kemi vendosur për veten, kudo që jetojmë dhe punojmë në botë, në mënyrë që të ndërtojmë dhe mirëmbajmë një biznes të qëndrueshëm për gjeneratat aktuale dhe të ardhshme.

Në përputhje me angazhimin tonë për qëllimin dhe për të vepruar në interes të publikut, ne e pranojmë se marrja e një shkalle rreziku është një pasojë e natyrshme e të bërit biznes. Për të ofruar shërbime të cilësisë së lartë të Auditimit dhe Dhënies së Sigurisë, ne identifikojmë dhe menaxhojmë në mënyrë proaktive rrezikun përmes proceseve, politikave dhe procedurave tona të kontrollit të cilësisë për të marrë vendime të informuara në përputhje me strategjinë dhe vlerat tona.

Ne aspirojmë të kemi një portofol klientësh që përputhen me vlerat tona të përbashkëta, respekton profesionistët tanë, njeh çështjet në zhvillim dhe përgjegjësitë shoqërore dhe angazhohet për të ofruar transparencë për palët e interesit në ekosistemin e raportimit financiar. Ne përpiqemi të kemi një portofol që nuk përfshin klientë të cilëve u mungon integriteti, përfshihen në aktivitete të paligjshme, shpërfillin vërtetësinë e kontabilitetit financiar dhe raportimit, ose nuk janë të gatshëm të vendosin dhe mbajnë kontrole të brendshme të mjaftueshme dhe procese të lidhura me to.”

Deloitte Audit Shqipëri ka politika dhe procedura të detajuara për pranimin e klientëve të mundshëm, vazhdimin e angazhimeve ekzistuese dhe vlerësimin e rrezikut të angazhimit. Këto politika dhe procedura janë hartuar me objektivin që Deloitte Audit Shqipëri të pranojë ose të vazhdojë me angazhime vetëm kur:

- Është në gjendje të kryejë angazhimin dhe ka aftësitë, duke përfshirë kohën dhe burimet, për ta bërë këtë.

- Mund të pajtohet me të gjitha standardet përkatëse profesionale dhe ligjet dhe rregulloret, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me etikën dhe pavarësinë dhe vlerësimet dhe konsideratat e konfliktit të interesit.
- Konsideron që ekipi menaxhues i klientit të veprojë me integritet dhe në përputhje me vlerat tona të përbashkëta.

Më pak, më të forta Firma anëtare

Brenda strukturës së firmës anëtare Deloitte, Deloitte Audit Shqipëri është pjesë e Deloitte Central Europe Holdings Limited firmë anëtare. Si një firmë lokale auditimi e regjistruar dhe e rregulluar në Shqipëri, ne kemi autoritetin vendimmarrës në lidhje me çështjet rregullatore dhe detyrimet profesionale dhe mbajmë përgjegjësinë përfundimtare për ekzekutimin e shërbimeve të Auditimit dhe Dhënies së Sigurisë në përputhje me standardet profesionale dhe ligjet dhe rregulloret lokale. Deloitte Audit Shqipëri është përgjegjëse për ruajtjen dhe funksionimin e një sistemi efektiv të menaxhimit të cilësisë për të mbështetur performancën e angazhimeve të Auditimit dhe Dhënies së Sigurisë me cilësi të lartë. Si anëtar i një firme të kombinuar brenda rrjetit Deloitte, ne punojmë në bashkëpunim të ngushtë me vendet e tjera gjeografike në firmën anëtare të Deloitte Central Europe Holdings Limited dhe përfitojmë nga mbikëqyrja shtesë e cilësisë, menaxhimit të rrezikut dhe aktiviteteve të monitorimit. Kjo strukturë nxit investimet e përbashkëta në inovacionin dhe burimet e Auditimit, si dhe ndarjen e praktikave udhëheqëse nëpër gjeografi, duke kontribuar në aspiratat tona kolektive për përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së Auditimit.

Në Deloitte, përmbushja e pritshmërive është vendi ku fillojnë shërbimet tona të Auditimit dhe Dhënies së Sigurisë.

Përkushtimi i njerëzve tanë ndaj integritetit, shërbimit në interes të publikut dhe ofrimi i sigurisë së cilësisë së lartë mbi fushat që kanë rëndësi më të madhe për palët tona të interesit janë thelbi i çdo gjëje që ne bëjmë.

Përkushtimi ynë i palëkundur ndaj cilësisë nxit pozicionin tonë të qëndrueshëm si drejtues të cilësisë. Ne mbetemi të fokusuar ndaj përsosmërisë mes njerëzve, proceseve dhe teknologjisë. Secili prej këtyre komponenteve thelbësorë na ndihmon të ofrojmë vizionin tonë për një të ardhme më të mirë, duke krijuar një ndikim që jo vetëm i plotëson pritshmëritë, por shkon përtej tyre.

Si duket kjo? Një praktikë auditimi dhe dhënie sigurie në zhvillim të vazhdueshëm, duke shfrytëzuar mendjet e ndritura, proceset efektive dhe teknologjitë e klasit botëror nga e gjithë organizata jonë, duke u mbështetur në përvojën tonë shumëvjeçare. Ne ofrojmë shërbime me cilësi të lartë në një mënyrë efikase dhe efektive që ruan integritetin, ndërton besimin dhe nxit vlerën duke u fokusuar në atë që ka vërtet rëndësi.

Transformimi i Auditimit dhe Dhënies së Sigurisë është një ndryshim domethënës për të gjithë rrjetin në mënyrën se si punojnë praktikuesit e Deloitte dhe përfshin:

Mënyra Deloitte: standartizimi i proceseve të Auditimit të mbështetura nga teknologjia gjithëpërfshirëse	Monitorimi i cilësisë së Auditimit në kohë reale
Fuqizimi i modelit talent, që përfshin të mësuarit, shpërblimet, qendrat e përsosmërisë dhe qendrat e zbatimit	Implementimi i shkathët i instrumenteve dhe teknologjive për t'u përgjigjur ndryshimeve rrethore

Ofrimi i përsosmërisë së auditimit përmes procesit, njerëzve dhe transformimit të teknologjisë

Me Mënyrën Deloitte, Deloitte po sjell standardizimin, konsistencën dhe eficientësinë për të udhëhequr cilësinë në thelbin e mënyrës se si ne auditojmë: me automatizimin që përmirëson detyrat rutinë, dhe analitikën që mbështesin zbatimin e auditimit – duke dhënë një perspektivë më të thelluar dhe më të kuptueshme të të dhënave. Si rezultat, ne po përmirësojmë cilësinë e auditimeve që kryejmë duke krijuar gjithashtu një përvojë talenti më të pasur për njerëzit tanë dhe duke u dhënë klientëve një përvojë efektive auditimi digjital, që ofron më shumë transparencë dhe shikueshmëri më të thellë.

Inovacioni është një pritshmëri e mjedisit të sotëm të biznesit që ndryshon me shpejtësi, dhe kjo pritshmëri vlen edhe për profesionin e auditimit. Mjedi i sotëm kompleks i biznesit i kërkon që auditimi të jetë dinamik, multidimensional dhe me kthjellues. Ka një kërkesë për informacion të menjëhershëm dhe relevant, dhe ne duhet të evoluojmë auditimet tona për të ndjekur inovacionet dhe proceset e bizneseve që auditojmë. Duke përdorur teknologjitë në zhvillim dhe të dhënat, Deloitte Audit Shqipëri ofron kuptim më të thellë për të krijuar auditime dhe dhënie sigurie më konsistent, të qartë dhe të vlefshëm për palët tona të interesit. Deloitte sjell mendje të ndritura, procese efikase dhe teknologji të klasës botërore nga gjithë organizata për të krijuar një ndikim që tejkalon pritshmëritë.

Audituesit e Deloitte Audit Shqipëri po përmirësojnë procedurat duke përdorur më shumë analizën e bazuar në të dhëna, si dhe teknologjitë e zgjuara dhe të bazuara në cloud si Inteligjenca Artificiale (AI). Kjo është pjesërisht për shkak të rritjes së automatizimit dhe efektivitetit që ofrojnë, por edhe nevojës që Deloitte Audit Shqipëri ka që të qëndrojë në krah të përparimeve teknologjike të përdorura nga subjektet që ne auditojmë.

Deloitte është e përkushtuar ndaj investimeve të vazhdueshme në teknologjitë në zhvillim dhe larminë e mendimeve që mundësojnë ofrimin e cilësisë, njohurive dhe vlerës së përmirësuar për klientët tanë dhe tregjet. Platformat e auditimit holistik të Auditimit të Deloitte, Deloitte Omnia dhe Deloitte Levvia, demonstrojnë angazhimin tonë për të ofruar auditime digjitale me cilësi të lartë të të gjitha madhësive dhe niveleve të kompleksitetit. Deloitte Omnia është platforma jonë e ofrimit të Auditimit të bazuar në cloud për cdo proces të auditimesh të mëdha, duke përfshirë entitete të listuara, ndërsa Deloitte Levvia ofron një eksperiencë auditimi digjital të efektshëm dhe gjithëpërfshirës për madhësinë e përshtatshme të subjekteve të zgjedhura private. Zhvillimi i vazhdueshëm, përmirësimi dhe vendosja më e gjerë e të dyja platformave do të vazhdojë gjatë disa viteve të ardhshme. Deloitte gjithashtu ka projektuar një zgjidhje

inovative të të dhënave dhe analitikës dhe paketa jonë e integruar e teknologjive të inovacionit mundësohen të gjitha ne cloud.

Auditimi në kohë trazuara

Në vazhdim të përçarjes së jashtëzakonshme globale të shënuar nga pasiguritë shëndetësore publike, politike dhe sociale gjatë viteve të fundit, janë prekur, profesioni së bashku me të gjithë palët e ekosistemit të raportimit të korporatave. Përgjigja e Deloitte ndaj pasigurive dhe ndërprerjeve ka përfshirë përpjekjet për të vazhduar avancimin e profesionit, duke i dhënë përparësi mirëqenies së njerëzve të saj.

Veçanërisht në mjedisin aktual, një ndërgjegjësimit i mprehtë në lidhje me rrezikun e rritur të mashtrimit, praninë e faktorëve të rrezikut në zhvillim ose dhe nevojën për mjedise efektive të kontrollit të brendshëm mbetet kritike. Megjithatë kornizat ekzistuese të kontabilitetit kanë provizione për pasiguri, përdoruesit dhe rregullatorët e pasqyrave financiare duhet të vazhdojnë të presin një shkallë më të lartë të luhatshmërisë së tregut dhe ekonomisë në një periudhë të afërt.

Deloitte ka mirëpritur vazhdimisht deklaratat publike dhe udhëzimet e lëshuara nga rregullatorët që njohin pasiguritë dhe theksojnë rëndësinë e informacioneve shpjeguese të korporatave me cilësi të lartë dhe largpamëse. Publiku përfiton nga transparencja më e madhe, ashtu si rritja e ndërgjegjësimit për këto çështje, veçanërisht kur marrin pjesë të gjithë aktorët e ekosistemit të raportimit të korporatave. Më shumë qartësi në lidhje me përgjegjësitë unike dhe plotësuese të menaxhimit, komiteteve të auditimit, shoqërive, audituesve, rregullatorëve dhe palëve të tjera të interesuara i mundëson publikut investues të mbajë përgjegjësi këto palë në një mënyrë që i shërben efektivisht interesit publik.

Vlera e shërbimeve të Auditimit dhe Dhënies së Sigurisë me cilësi të lartë nuk është zvogëluar në mes të trazirave globale. Përkundrazi, investitorët dhe palët e tjera të interesuara vazhdojnë të kërkojnë shërbime profesionale të bazuara në parimet dhe praktikën e bazuara në pavarësi dhe objektivitet për të krijuar besim dhe për të frymëzuar besim në tregjet e kapitalit – dhe Deloitte është e përkushtuar të udhëheqë rrugën.

Angazhimi i Deloitte Audit Shqipëri për t'i shërbyer interesit publik – veçanërisht kur lidhet me sjelljen sipas standardeve më të larta të etikës, integritetit, pavarësisë dhe transparencës është i palëkundur. Deloitte është shumë i vetëdijshëm për peshën e përgjegjësisë që vjen me përmbushjen e detyrimeve profesionale dhe përmbushjen e rolit të saj si Auditues brenda ekosistemit të raportimit të korporatës në nivel global. Parimet e mëposhtme mbeten në krye dhe përforcohen vazhdimisht me praktikuesit e Auditimit dhe Dhënies së Sigurisë:

- Ushtrimi i skepticizmit profesional dhe kujdesit të duhur profesional
- Vlerësimi në mënyrë kritike cilësinë e evidencës së marrë të auditimit dhe përcaktimi nëse është e

mjaftueshme dhe e përshtatshme për të adresuar rreziqet përkatëse

- Të bërit gjykime të arsyetuara profesionale të mbështetura në dokumentacion të qartë
- Të nxiturit e një kulturë përsosmërie dhe konsultimi
- Demonstrimi i përkushtimit ndaj integritetit dhe sjelljes etike, duke përfshirë respektimin e detyrimeve rregullatore dhe profesionale
- Të qëndruarit të lidhur dhe të mbështesim njëri-tjetrin.

Modeli multidisiplinar (MDM)

Modeli i fuqishëm multidisiplinar i biznesit i Deloitte përfshin auditimin dhe dhënien e sigurisë, taksat, konsulencën, si dhe praktikën e këshillimit ndaj rrezikut dhe financiare dhe është një kontribues i rëndësishëm në aftësinë e organizatës për të ofruar shërbime auditimi dhe dhënie sigurie me cilësi të lartë. Konkretisht, fusha e raportimit të korporatave ka filluar të zgjerohet dhe pritet të transformohet në mënyrë drastike në të ardhmen e afërt; Pasqyrat financiare dhe shënimet e korporatave do të vazhdojnë të bëhen më komplekse për shkak të konsideratave të ESG-së dhe çështjeve të tjera (cyber, AI, privatësia e të dhënave, etj.). Për më tepër, ndërsa të dhënat e mëdha dhe përparimet e tjera digjitale bëhen rutinë, kërkesa për analistë të të dhënave dhe specialistë të IT-së do të rritet në përputhje me rrethanat.

MDM mbetet thelbësor për shërbimet ndërdisiplinore të Deloitte në nivel global. Deloitte krenohet që ka një grup specialistësh të thelluar e të pavarur, të cilët mund të vendosen në të gjithë botën për angazhime për të ofruar ekspertizë për çështjen dhe perspektiva të reja, të detajuara. Deloitte beson se MDM-ja aktuale ndihmon organizatën të kryejë auditime dhe angazhime të dhënies së sigurisë me cilësi të lartë në interes të publikut dhe përforcon qëndrueshmërinë e praktikës së Auditimit dhe Dhënies së Sigurisë. Pikat e forta të MDM përfshijnë:

- Mundësinë për të zhvilluar njohuri të industrisë ose tematika (p.sh., klima, qeverisja, strategjia e korporatës, etj.) përmes lenteve të shumta, gjë që rrit të kuptuarit e Audituesëve për rreziqet e biznesit që lidhen me kryerjen e auditimeve.
- MDM mundëson aksesin tek specialistët funksionalë dhe ekspertët e industrisë të cilët janë të pavarur dhe që ofrojnë mbështetje auditimi duke ndihmuar në kryerjen e auditimeve me cilësi të lartë. Kjo do të bëhet më e rëndësishme ndërsa shkojmë drejt raportimit më të gjerë të korporatës.
- Gjerësia e MDM-së është tërheqëse për kandidatët që mund të mos dëshirojnë t'i kufizojnë opsionet e karrierës së tyre vetëm në ofrimin e shërbimeve të Auditimit dhe Dhënies së Sigurisë.
- Shkalla e MDM sjell më shumë elasticitet për çdo linjë biznesi Deloitte, duke përfshirë auditimin dhe dhënien e sigurisë, duke lejuar investime të vazhdueshme në teknologji, metodologji dhe procese për të mbështetur ofrimin e shërbimeve me cilësi të lartë.

Drejtimi i Deloitte pranon se çdo linjë biznesi Deloitte është e rëndësishme dhe kritike për aftësinë e organizatës për të përmbushur përgjegjësitë e saj për interesin publik. Vëmendja e menaxhimit dhe shpërndarja e investimeve nuk kufizohet në linjat e biznesit me normat më të larta të rritjes.

Deloitte pranon mundësinë dhe perceptimin e konflikteve të interesit, dhe për këtë arsye ka politika dhe sisteme të fuqishme konfliktesh dhe pavarësie për të siguruar që strategjia e Deloitte të zbatohet në përputhje me kërkesat rregullatore dhe profesionale. Në disa fusha, politikat e Deloitte janë më të rrepta se standardet, ligjet ose rregulloret profesionale.

Raportimi mjedisor, social dhe i qeverisjes (ESG).

Themelet e biznesit po ndryshojnë me shpejtësi - qëndrueshmëria afatgjatë dhe aftësia për të krijuar vlera të qëndrueshme është e lidhur drejtpërdrejt me përafrimin me vlerat dhe pritshmëritë e shoqërisë. Pjesëmarrësit e tregut dhe palët e tjera të interesuara po bëjnë thirrje për një pasqyrë më të madhe se si organizatat po ndërtojnë, mbrojnë dhe rrisin vlerën e ndërmarrjes me kalimin e kohës, dhe po kërkojnë në mënyrë specifike transparencë të zgjeruar rreth ndikimeve klimatike dhe ESG më të gjera si dhe varësive të modelit dhe strategjisë së biznesit të një kompanie.

Në mënyrë të veçantë, Deloitte pranon se ndryshimi i klimës përbën një rrezik për stabilitetin financiar dhe ndikon gjerë në shumë sektorë të biznesit me rritjen e pritshmërive të shënimeve dhe raportimit nga aktorë të ndryshëm.

Deloitte po ndërmerr veprime strategjike për të edukuar njerëzit tanë mbi ndryshimet klimatike dhe ndikimin e mundshëm në shoqëritë e audituara për të mbështetur ekzekutimin e auditimeve cilësore, duke i dhënë kështu konsideratën e duhur rreziqeve dhe mundësive të lidhura me klimën. Kjo përfshin vendosjen e materialeve të tilla si një kurrikulë mësimore për klimën, si dhe një kornizë dhe udhëzime përkatëse për të marrë në konsideratë çështjet e lidhura me klimën si pjesë e Auditimit.

Raportim më i gjerë i korporatës

Raportimi financiar tradicional ka filluar të evoluojë në raportim më të gjerë të korporatës. Për të mbështetur këtë evolucion, ekzistojnë përpjekje për vendosjen e standardeve dhe rregullore në lidhje me qëndrueshmërinë nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Qëndrueshmërisë (ISSB) dhe të tjerë në mbarë botën.

Këto standarde theksojnë nevojën për një lidhje më të mirë ndërmjet raportimit financiar dhe jofinanciar dhe do të ndihmojnë përdoruesit e informacioneve shpjeguese të korporatave të kuptojnë dhe krahasojnë më mirë informacionin rreth njësive ekonomike. Më tej, këto standarde do të mundësojnë transparencë, qëndrueshmëri dhe krahasueshmëri më të madhe globale, si dhe do të zhvendosin kërkesat për raportimin e lidhur me klimën nga të qenit vullnetar në të detyrueshëm.

Për të qenë efektive, standardet duhet të miratohen globalisht në një mënyrë të qëndrueshme për të ofruar raportim të korporatës i cili është i krahasueshëm, bazuar në praktikën globale dhe plotësohet nga konsideratat lokale aty ku është e justifikuar. Këto standarde do të duhet gjithashtu të futen në rregullore në mbarë botën, së bashku me zbatimin, monitorimin, qeverisjen dhe kontrollin, sigurimin dhe trajnimin. Zhvillimet në përcaktimin e standardeve dhe bërjen e rregullave synojnë jo vetëm të krijojnë transparencë dhe konsistencë në raportimin bazë global, por gjithashtu të bëjnë

të qartë se informacioni në raportimin financiar dhe informacioni i përmbajtur në raportimin e qëndrueshmërisë së bashku janë të dhëna thelbësore për të informuar këndvështrimin e palëve të interesuara për vlerën e një njësie ekonomike.

Prandaj, ekziston një kërkesë në rritje për kompanitë që të integrojnë konsideratat të lidhura me klimën dhe me gjerësisht ESG në politikën dhe procedurat e kontrollit të brendshëm, duke rritur pjekurinë e sistemeve, proceseve dhe qeverisjes mbi informacionin e lidhur me klimën dhe informacione të tjera të ESG. Si rezultat, ata që janë të ngarkuar me qeverisjen (p.sh., komitetet e auditimit, bordet) po përfshijnë gjithnjë e më shumë konsideratat e ESG-së në përgjegjësitë e tyre mbikëqyrëse të menaxhimit të një organizate, raportimit të saj dhe proceseve dhe kontrolleve të mbledhjes së të dhënave.

Deloitte kupton se duke pasur parasysh rreziqet e shtuara që lidhen me ndryshimet klimatike, është e rëndësishme që faktorët e lidhur me klimën të përfshihen siç duhet në raportimin e korporatës. Sot disa pritshmëri të palëve të interesuara mund të mos përmbushen nga pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me kornizat aktuale të kontabilitetit. Ndërsa raportimi i korporatave vazhdon të evoluojë dhe palët e interesuara mësohen dhe përshtaten me ndryshimet e tregut dhe ndjenjën publike, është e rëndësishme të lejohet një proces i duhur diligjence në mënyrë që të zhvillohen standarde aplikimi të qëndrueshme dhe të vazhdueshme në të gjithë globin dhe për të nxitur raportimin që i përgjigjet kërkesave në rritje të investitorëve dhe palëve të tjera të interesuara.

Deloitte mbetet i përkushtuar për t'u angazhuar në biseda kuptimplota dhe transparente me investitorët, vendosësit e standardeve, rregullatorët dhe palët e tjera të interesuara. Ne gjithashtu presim me padurim të mbështesim standardet e reduktuara dhe fragmentimin rregullator dhe të nxisim besim më të madh të tregut, ndërsa konsistenca në standardet realizohet globalisht.

Dhënia e sigurisë

Me rritjen e fokusit dhe shqyrtimit të raportimit të ESG-së vjen gjithashtu nevoja e shtuar për besim mbi cilësinë e shënimeve dhe rritjes së thirrjeve për kërkesat e Dhënies së Sigurisë. Juridiksionet individuale, si Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara, po lëvizin për të futur ose forcuar rregulloren rreth raportimit të qëndrueshmërisë. Kërkesat e Dhënies së Sigurisë po bëhen gjithnjë e më të detyrueshme.

Dhënia e Sigurisë mbi informacionin ESG duhet të pritet të ndjekë një kornizë profesionale duke përfshirë kompetencën, pavarësinë, një sistem të menaxhimit të cilësisë dhe t'i nënshtrohet mbikëqyrjes dhe inspektimit, si dhe mekanizmave të përgjegjësive profesionale për të siguruar që siguria e besueshme të ofrohet në treg.

Më poshtë janë veprimet specifike që Deloitte po ndërmerr për të mbështetur ekzekutimin e përshtatshëm të Dhënies së Sigurisë cilësore e cila adreson raportimin vullnetar të ESG dhe kërkesat rregullatore:

- Angazhimi në formësimin e infrastrukturës së tregut të kapitalit për raportimin e qëndrueshëm, i lidhur me vlerën e ndërmarrjes përmes bashkëpunimit për raportimin e përcaktimit të standardeve të klimës dhe ESG, dhe iniciativave të Dhënies së Sigurisë, të tilla si Fondacioni IFRS, Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Auditimit dhe Dhënies së Sigurisë dhe Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Etikës për Kontabilistët.
- Pjesëmarrja aktive në platforma të ndryshme globale si Forumi Ekonomik Botëror dhe Konventa Kuadër e OKB-së e vitit 2022 për Ndryshimet Klimatike (COP27).
- Vendosja e udhëzimeve të zgjeruara për të ofruar siguri të kufizuar dhe të arsyeshme ESG përmes metodologjisë

globale të Dhënies së Sigurisë të qëndrueshmërisë së Deloitte. Ndërtimi i kapaciteteve mësimore globale dhe lokale të fokusuara në ESG.

- Zhvillimi i mjeteve teknologjike, duke përfshirë një mjet për të vlerësuar zbulimet e qëndrueshmërisë së një kompanie kundrejt standardeve të zakonshme ESG.

Deloitte mbështet bashkëpunimin e vazhdueshëm të të gjithë pjesëmarrësve në ekosistemin e raportimit të korporatës, duke punuar së bashku për të zhvilluar dhe zbatuar standarde të përbashkëta mbi të cilat matet, zbulohet dhe përfundimisht sigurohet informacioni ESG.

Angazhimi i Deloitte

Më tej, për të ndihmuar botën të arrijë qëllimet e Marrëveshjes së Parisit, Deloitte ka lançuar [WorldClimate](#), një strategji për të drejtuar zgjedhje të përgjegjshme klimatike brenda rrjetit Deloitte dhe më gjerë.



Zhvillimi profesional dhe menaxhimi i performancës

Kultura e përsosmërisë së Deloitte dhe hartimi i programeve mësimore i vendos njerëzit në paravijë. Praktikuesit e Deloitte janë teknikisht të aftë me nivele të larta të etikës, integritetit, skepticizmit profesional dhe objektivitetit, duke zbatuar gjykimin dhe përvojën e tyre me pasion dhe përkushtim. Ne po përmirësojmë vazhdimisht aftësitë, njohuritë dhe përvojën tonë për të shkuar përtej pritshmërive dhe për të shkaktuar ndikim domethënës.

Deloitte përkushtohet të ofrojë një përvojë të pakrahasueshme talentesh, të zhvillojë praktikues dhe të çojë më tej karrierën e tyre duke krijuar një mjedis mësimor gjatë gjithë jetës - duke avancuar edukimin e Auditimit, aftësitë dhe opsionet fleksibël të karrierës që tërheqin Audituesët e sotëm dhe të nesërm.

Pratikuesit e Deloitte sjellin eksperiencë, njohuri dhe aftësi të ndryshme që e rrisin aftësinë e organizatës në kryerjen e auditimeve cilësore. Ne mbështesim dhe fuqizojmë njerëzit tanë që të arrijnë potencialin e tyre të plotë duke vlerësuar dhe demonstruar diversitetin, barazinë, përfshirjen dhe mirëqenien. Për më tepër, disiplina operacionale, menaxhimi efektiv i biznesit dhe zhvillimi i një përqasjeje të veçantë për kryerjen e auditimeve të njohur si Mënyra Deloitte, ofrojnë themelin për angazhimin e Deloitte për të sjellë konsistencë në auditimet tona.

Deloitte njeh dhe shpërblen praktikuesit dhe profesionistët e saj të Auditimit dhe Dhënies së Sigurisë dhe kryen investime domethënëse në të ardhmen e tyre.



Iniciativat mësimore zhvillimore

Qasja e transformuar e Deloitte për ofrimin e Auditimit po ndryshon përvojën e Auditimit për praktikuesit. Ekipe e Auditimit fuqizohen nga mjetet dhe teknologjitë e avancuara dhe përdorimi më i gjerë i të dhënave dhe analitikave brenda një fluksi pune të drejtuar për të ekzekutuar auditimin nga skaji në skaj. Për praktikuesit e Deloitte, kjo do të thotë përqendrimi në mënyrën se si angazhimi planifikohet, ekzekutohet dhe menaxhohet në mënyrë të vazhdueshme në të gjithë globin duke përdorur teknikat dhe aftësitë tona inovative. Ajo gjithashtu ofron mundësi për të rritur aftësitë dhe kompetencat e tyre teknike dhe profesionale. Për shembull, aftësitë e mëposhtme mbeten po aq të rëndësishme sa kurrë më parë - analitika e përmirësuar e të dhënave, menaxhimi i projektit, mendimi kritik, komunikimi, gjykimi profesional dhe aplikimi i parimeve të kontabilitetit dhe auditimit për të punuar në mënyrë më efektive dhe për të ofruar angazhime me cilësi të lartë. Ndërsa aftësitë dhe grupet e aftësive rriten, ne ndërtojmë besim më të madh dhe bëhemi vlerësues gjithnjë e më të mirë të rrezikut.

Deloitte ka bërë investime të konsiderueshme në strategjitë për talentet dhe mësimore dhe ka transformuar kurrikulën teknike të auditimit për të ndërtuar aftësitë e rifreskuara të kërkuara sipas nivelit:

- Në thelb, Deloitte ka një kurrikulë të vetme, të detyrueshme mësimore teknike të auditimit, të përshtatur sipas nivelit të studjesit, duke përdorur një përzierje dinamike të kurseve digjitale sipas kërkesës, të udhëhequra nga instruktorët e drejtpërdrejtë dhe aktivitetet në punë.
